



MIRATOHET

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARIË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTEJTT PËR VITIN 2021

#### Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbyshje të misionit të tij për dhënie të informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet një procesi demokratik, transparent, mbrojtjes së personalitetit të individit, si dhe unitetit e pajtimit kombëtar;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga partimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

#### Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2021 në drejtim të:

Nënshtkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim përcaktimin e kontributit të secilës palë dhe bashkërendimin e veprimtarisë midis institucioneve për të garantuar realizimin e një procesi të rregullt ligjor, në funksion të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit.

Përkallëzimit të veprimtarisë së Autoritetit me zhvillimin e tryezave ndërinstitucionale në lidhje me hartimin e akteve nënligjore që do të përcaktojnë autoritetet përgjegjëse dhe mënyra e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara.

Intensifikimit të marrëdhënieve me institucionet homologe të vendeve ish-komuniste si një mënyrë efektive për t'u njohur dhe përfutur nga përvoja e tyre në përmbyshjen e misionit të Autoritetit.

Pranimi të Autoritetit si anëtar me të drejta të plota në Rrjetin Europian të Arkivave të ish-Policive Sekrete.  
Finalizimi të "Udhërrëfyesit për të drejtat e familjarëve të të zhdukurve të komunizmit" dhe shpërndarjes së tij gjërisht gjatë takimeve në qytete të ndryshme të vendit të zhvilluara në kuadër të edukimit qytetar.

### **Kuendi kërkon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022 të angazhohet në këto drejtime:**

Të vijojë angazhimin për hartimin e draftit të aktit nënligjor, i cili do të përcaktojë autoritetet përgjegjëse dhe mënyrën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vendvarrimeve të identifikuar ose të dyshuara duke dhënë kontribut në përcaktimin e de tyre të AIDSSH-së në këtë proces, por edhe në gjërë, në kuadër të bashkëpunimit me institucionet e tjera shtetërore gendrore dhe vendore.

Të vijojë përpjekjet për dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme, në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me autoritetet publike dhe arkivat për zbatimin e detyrimeve ligjore.

Të intensifikojë bashkëpunimet me institucionet qeveritare për qartësimin e fatit të të zhdukurve në komunizëm, në komunikimin me familjet, grupet e interesit, pushtetin lokal, organizatat ndërkombëtare.

Të bëjë funksional sistemin e arkivit digital për lehtësim të procesit të kërkimit dhe konsultimit me dokumentet arkivore sipas standardeve ndërkombëtare.

Të bashkëpunojë ngushtë me ISKK-në sa i takon shtrëztimit të dokumentacionit arkivor sipas parashikimeve ligjore, me qëllim garantimin e mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve nga ana e studuesve duke mbështetur kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit.

Të intensifikojë bashkëpunimin me institucione homologe të huaja, me qëllim përhithjen e ekspertencave më të mira nga veprimtaria e tyre.

Të intensifikojë punën për deklasifikimin e dosjeve, duke përjashtuar ato që cenojnë sigurinë kombëtare dhe të vijojë me digitalizimin e tyre.

Të publikojë në faqen zyrtare online të Autoritetit, për aq sa lejohet nga kuadri ligjor, listën e individëve që kanë rezultuar si bashkëpunëtorë të ish-Sigurimit të Shtetit dhe që janë pjesë e administratës publike.

Miratuar në datën 21.7.2022